


A K T - T H E M E L I M I
SHOQERIA " E R S I " sh.p.k. BALLSH



Sot me date 10.12.1999 une i nenshkruari :

GEZIM GOXHAJ , i biri i Aliut , lindur ne vitin 1959 , banues ne Ballsh te rrethit Mallakaster , me deshiren dhe vullnetin tim te plote , ne mbeshtetje te ligjes nr.7638 dt. 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " dhe nr.7667 dt. 28.1.1993 " Per rregjistrimin ne rregjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare " , vendosa qe te formuloj kete akt per themelimin e nje shoqerie tregetare private me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.) si me poshte vijon :

- **NENI 1** - Te formohet Shoqeria Tregetare , me pergjegjesi te kufizuar , me emertimin " ERSI " sh.p.k. BALLSH .
- **NENI 2** - Shoqeria do te kete qendren e vet ne lagjen "5 Shkurti" te qytetit te Ballshit , ne Republikën e Shqiperise .
- **NENI 3** - Shoqeria krijohet per nje aktivitet kohezgjatje mbi 10 vjet pune te njepasnjeshme . Ky afat mund te zgjatet , por mund edhe te shkurtohet per rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktimeve qe do te pasqyrohen ne statut .
- **NENI 4** - Themeluesi i shoqerise eshte z.Gezim Goxhaj , i cili eshte edhe ortak i vetem i saj.
- **NENI 5** - Shoqeria tregetare " ERSI " sh.p.k. ka per objekt te aktivitetit se saj :
 - Veprimtari ne fushen e projektimit e zbatimit si :
 - ndertime civile , industriale , turistike , bujqesore , social-kulturore, punime , sistemime , tarracime terrenesh ;
 - analizime e vepra te tjera hidroteknike , rruge , ura e vepra arti ;
 - konstrukcione te ndryshme , veshje fasadash , mirembajtje e zhvillim dekori ne mjedise urbane , etj. te ketij lloji .
 - Prodhim dhe tregetim materialesh inerte e materiale te tjera ndertimi , import-eksport .
- **NENI 6** - Per fillimin e aktivitetit te kesaj shoqerie themeluesi i saj ka vene nje kapital fillestar qe kap shumen prej 100.000 leke , shume e cila eshte prone vetiake e themeluesit i cili eshte edhe ortak i vetem i saj . Gjithashtu shoqeria do te cele edhe nje llogari rrjedhese dhe likuiduese prane Bankes .
- **NENI 7** - Fitimi i shoqerise i perket teresisht ortakut te vetem te saj z. Gezim Goxhaj . Ky fitim do te disponohet lirisht prej tij pasi te jene shlyer me pare detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj te treteve .



Gezim Goxhaj



- **NENI 8** - Organ drejtues ne shoqeri eshte Administratori i saj z. Gezim Goxhaj , i cili e perfaqeson juridikisht ate ne te gjitha organet apo organizmat e aparatit shteteror si dhe ne marrredheniet me te tretet kur veprimet kane te bejne me disponimin e interesave materiale te shoqerise .
- **NENI 9** - Drejtuese teknike ne shoqeri ne fushen e ndertimit eshte znj. Fatbardha Goxhaj , e licensuar ne kete fushe . Drejtuesi teknik nderrohet sipas interesave te shoqerise kundrejt kontrates se bere midis tyre . Shoqeria ka te drejte qe te punesoje specialiste ose punonjes te tjere me kontrate pune me shkrim sipas percaktimeve ne legjislacionin e punes ne fuqi .
- **NENI 10** - Do te konsiderohen veprimtari e shoqerise vetem ato veprime juridiko-civile qe do te kryhen nga organet ose punonjesit e saj konforme disponimeve ne statutin e saj dhe ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.
- **NENI 11** - Si rregull veprimet ekonomike te shoqerise do te mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti ; perjashtim nga ky rregull do te behet vetem kur e kerkon organi kompetent ligjor .
- **NENI 12** - Shoqeria do te shperbehet sipas rasteve qe do te percaktohen ne statutin e saj .
- **NENI 13** - Mosmarreshjet qe mund te lindin midis personave pjesemarres ose jo ne shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim midis tyre. Ne rast se kjo nuk arrihet ato do te zgjidhen nga gjykata kompetente sipas legjislacionit shqiptar .
- **NENI 14** - Ky akt - themelimi perpilohet ne 4 kopje te barabarta ne gjuhen shqipe , nje kopje prej te cilave do te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare "ERSI" sh.p.k.



Ballsh, me 10 Dhjetor 1999

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
Nr. 1832 Regj. ... 312/1 Kol.

ADMINISTRATORI

(Gezim Goxhaj)
Gezim Goxhaj

12.12.1999

VERTETIM

Vertetoj se para meje noterit u paraqit shtetasi : Gezim Goxhaj , i biri i Aliut , lindur ne vitin 1959 , lindur ne Hekal dhe banues ne Ballsh , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili e nenshkroi aktin ne prezencen time .

Une noteri vertetoj duke e nenshkruar aktin .



NOTER
KADRI BILALI

Kadri Bilali



STATUT I SHOQERISE " E R S I " sh.p.k. BALLSH

Sot ne daten 10/12/1999 , administratori themelues i shoqerise si ortak i vetem i saj , z . Gezim Goxhaj , ne mbeshtetje te Aktit te themelimit date 10/12/1999 , harton kete statut baze per karakterin dhe veprimtarine e shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar , i cili konsiston si me poshte :

Forma , Emri

Neni 1

Shoqeria do te jete nje shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar , me emertimin " E R S I " Ballsh sh.p.k. dhe e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar per shoqerite tregetare , statutin e saj dhe aktin e themelimit .

Kohezgjatja

Neni 2

Shoqeria krijohet per nje aktivitet me kohe zgjatje mbi 10 vjet pune te njepasnjeshme duke filluar ky afat nga data e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se rrethit Tirane .

Neni 3

Periudha e veprimtarise ekonomike mund te zgjatet me vendim te administratorit themelues te shoqerise si ortak i vetem i saj ose mund te shkurtohet ne rastin kur do te vertetohet shperberja e shoqerise para afatit te percaktuar ne nenin 2 te ketij statuti .

Qendra e Shoqerise

Neni 4

Shoqeria qendren e e saj e ka ne lagjen " 5 Shkurti " , qyteti i Ballshit , rrethi i Mallakastres , Republika e Shqiperise .

Administratori i saj ka te drejte qe te ndryshoje vendin e qendres se shoqerise .


Shoqeria me vendim te administratorit te saj mund te cele vendqendrimet te dyta operative .

Neni 5

Shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar mund te cele dege te saj edhe ne qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte saj . Keto dege do te krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe te vendeve ku do te ngrihen .

Neni 6

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj duke pasur ne perdorim nje vule ne forme te percaktuar ne te cilen do te shenohen emri si dhe qendra e aktivitetit te shoqerise .



Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 7

Shoqeria tregetare " ERSI " sh.p.k. Ballsh ka per objekt te saj :

- Veprimtari ne fushen e projektimit e zbatimit si :
 - ndertime civile , industriale , turistike , bujqesore , social-kulturore , punime , sistemime , tarracime terrenesh ;
 - kanalizime e vepra te tjera hidroteknike , rruge , ura e vepra arti ;
 - rikonstruksione te ndryshme , veshje fasadash , mirembajtje e zhvillim dekori ne mjedise urbane , etj. te ketij lloji .
 - Prodhim dhe tregetim materialesh inerte e materiale te tjera ndertimi , import-eksport .

Neni 8

Administratori i shoqerise si ortak i vetem i saj ka te drejte te zgjeroje aktivitetin e tij ne te ardhmen duke lidhur kontrata apo akt-marreveshje me persona fizike ose juridike , vendas ose te huaj . Mbi kete baze do te zgjerohet edhe fusha e veprimtarise se shoqerise .

Neni 9

Do te konsiderohen veprimtari e shoqerise vetem ato veprime juridiko-civile qe do te kryhen nga organet ose punonjesit e saj konforme disponimeve ne kete statut dhe kurdohere ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi .

Drejtuese teknike ne fushen e ndertimit do te jete Fatbardha Sefer Goxhaj , e diplomuar si inxhinier ndertimi dhe e paisur me license . Drejtuesi teknik mund te nderrohet sipas interesave te shoqerise sipas kontrates se hartuar midis ketyre paleve .

Kapitali themelor i shoqerise

Neni 10

Per fillimin e aktivitetit te kesaj shoqerie administratori themelues si ortak i vetem i saj ve nje kapital fillestar qe kap shumen prej 100.000 leke , shume e cila eshte kontribut dhe prone vetiake e administratorit .

Neni 11

Per administrimin dhe qarkullimin e kapitalit te shoqerise hapet edhe nje llogari rrjedhese dhe likuiduese prane Bankes . Kapitali themelor i shoqerise eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie ose ne forme shitje . Tjetersimi i pasurise ne keto raste do te behet sipas kriterëve te percaktuara ne ligj .

Neni 12

Shoqeria ka te drejte qe te lere peng me vendim te administratorit te saj teresisht ose pjeserisht kapitalin e saj themelor kur nje veprim i tille do te cmohet me leverdi ekonomike per interesat e shoqerise .

Neni 13

Shoqeria ka te drejte qe sipas nevojave qe mund ti paraqiten gjate ushtrimit te aktivitetit te saj te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale .

Ajo ka te drejte te leshoje me qera pasurite e saj .



Neni 14

Gjithe fitimi i kesaj shoqerie i perket ortakut te vetem Gezim Goxhaj , i cili eshte edhe pronar i saj . Ky fitim do te disponohet lirisht prej tij pasi te jene shlyer me pare detyrimet fiskale dhe ato ndaj te treteve .

Organet drejtuese te shoqerise

Neni 15

Organ drejtues dhe vendimor ne kete shoqeri eshte administratori i saj , Gezim Goxhaj , i cili e perfaqeson juridikisht ate ne te gjitha organet apo organizmat e aparatit shteteror si dhe ne marredheniet me te tretet kur veprimet kane te bejne me disponimin e interesave materiale te shoqerise .

Neni 16

Me autorizim me shkrim te nenshkruar nga administratori , shoqerine mund ta perfaqesoje cdo person tjetër .

Neni 17

Administratori i shoqerise ka keto te drejta dhe obligime kryesore :

- Organizon punen dhe perfaqeson shoqerine .
- Lidh dhe nenshkruan kontrata si dhe akte te tjera .
- Ben caktimin e puntoreve ne vendet e punes .
- Jep masat disiplinore .
- Ben zgjidhjen e konflikteve ne mes te puntoreve .
- Kujdeset per zbatimin e dispozitave ligjore , dispozitave te ketij statuti dhe akteve ligjore dhe nenligjore qe kane lidhje me veprimtarine private .

Administrimi , viti financiar , bilanci

Neni 18

Mjetet e investuara per themelimin e shoqerise si dhe ato te shtuara nga aktiviteti i saj i zgjeruar rregjistrohen ne librin afarist te shoqerise menjehere .

Shoqeria eshte pronare , perdoruese dhe disponuese e pasurive ne emer te vet ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj .

Neni 19

Shoqeria shfrytezon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financimi per zhvillimin e saj , per nxitjen ekonomike , te valutes , etj . Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera ose nga shumet suplementare qe mund te derdhe per kete qellim administratori , kur detyrimet nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese .

Neni 20

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti .

Llogarite vjetore , inventari , raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe cdo raport tjetër i vecante ne kete drejtim pasi shqyrtohen , i paraqiten per miratim administratorit te shoqerise brenda 3 muajve dhe ne cdo rast jo me vonë se 3 muaj nga data e mbylljes se vitit .



Neni 21

Pasurite e shoqerise vleresohen ne bilancet e saj me vlera te shprehura ne monedhe shqiptare dhe te huaj , ne perputhje me dispozitat ligjore perkatese te zbatuara ne Shqiperi . Shkembimi i monedhes shqiptare ne te huaj dhe e kunderta behet ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka ne momentin e kembimit te saj .

Punesimi ne shoqeri

Neni 22

Per realizimin e aktivitetit te saj ne rritje shoqeria mund te punesoje specialiste ose punonjes me profesione te ndryshme me kontrate-pune me shkrim sipas percaktimeve ne legjislacionin per marredheniet e punes ne fuqi .

Neni 23

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes , te cilat mund te jene kolektive dhe individuale .

Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar si Kodi i Punes dhe cdo akt tjeter ligjor dhe nenligjor qe ka te beje me kete ceshtje .

Neni 24

Ne kontraten e punes percaktohen detyrimet reciproke te shoqerise me punonjesit , te cilet jane ne marredhenie pune me te .

Per punen e tyre ne shoqeri punonjesit marrin pagen e tyre , e cila pavaresisht nga rezultatet e arritura ne pune percaktohet ne kontraten e punes .

Neni 25

I punesuari nuk merr pjese ne ndarjen e fitimit te cilin e realizon shoqeria gjate veprimtarise se saj apo edhe ne humbjet e saj nese ne kontraten e punes nuk eshte percaktuar ndryshe .

Ai pergjigjet materialisht per demet qe i shkaktohen shoqerise me faj (me dashje apo nga pakujdesia) .

Sekreti afarist i shoqerise

Neni 26

Sekret afarist konsiderohen dokumentat dhe te dhenat , te cilat jane me rendesi per punet e shoqerise . Komunikimi i tyre personave te pa autorizuar per shkak te rendesise se tyre do te ishte ne kundërshtim me interesat e shoqerise .

Te dhenat dhe dokumentat te cilat konsiderohen sekret afarist mund t'ju komunikohen personave te tjere vetem nga administratori i shoqerise .

Neni 27

Sekretin afarist jane te detyruar ta ruajne te gjithe punonjesit . Detyrimi i ruajtjes se sekretit afarist nuk pushon edhe pas nderprerjes se punes me shoqerine .

Zbulimi (dhenia) i sekretit afarist paraqet shkelje te rende te detyrave te punes , e nese eshte caktuar me ligj edhe veper penale .



Shperberja dhe likuidimi i shoqerise
Neni 28

Shoqeria mund te shperbehet ne rastet :

- Me vendim te administratorit te saj kur per dy vjet radhazi shoqeria nuk rezulton rentabel .
- Me plotesimin e afatit te kohezgjatjes se aktivitetit te shoqerise .
- Ne rast falimentimi ekonomik .
- Ne ato raste kur shprehimisht do te citohet nje gje e tille nga legjislacioni ne fuqi .

Neni 29

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit te saj qysh ne momentin e prishjes ose te shperberjes .

Pas shlyerjes se detyrimeve tatuese fiskale dhe ato ndaj te treteve , percaktohen pasurite e ngelura te cilat i kthehen teresisht administratorit te shoqerise i cili eshte edhe pronar i vetem i saj .

Dispozita te pergjitheshme

Neni 30

Mosmarveshjet juridiko-civile te lindura midis personave pjesemarres ose jo ne shoqeri , kur nuk mund te zgjidhen me mirekuptim me njeri tjetrin , do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane ose cdo gjykate tjeter kompetente sipas legjislacionit shqiptar .

Neni 31

Ky statut perpilohet ne kater kopje te barabarta ne gjuhen shqipe dhe hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te shoqerise ne Gjykatën e Rrethit Tirane ; nje kopje e ketij statuti do te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare " E R S I " sh.p.k.

Ballsh , me 10/12/1999

ADMINISTRATORI I SHOQERISE

(*Gezim Goxhaj*)

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE


Nr. 1539...Regj. 3.16... Kol.

12.12.1999

VERTETIM

Vertetoj se para meje noterit u paraqit shtetasi : Gezim Goxhaj , i biri i Aliut , lindur ne vitin 1959 , lindur ne Hekal dhe banues ne Ballsh , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , i cili e nenshkroi aktin ne prezencen time .

Une noteri vertetoj duke e nenshkruar aktin .



NOTER :
KADRI BILALI